



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Komisioni për Arsim, Shkencë,
Teknologji, Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja e datës 18.07.2007
Salla nr. N.225, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nimon Alimusaj, Remzije Nimani, Gjylshen Berisha, Ragip Zekolli, Mark Krasniqi, Myrvete Dreshaj, Nuran Malta, Genc Gorani, ndërsa munguan: Enver Hoxhaj, Gojko Savic, Drita Statovci, Sala Ahmetaj, Naxhije Doçi dhe Ramë Buja.

Në mbledhje mori pjesë: Bajrush Morina – përfaqësues nga MKRSÇJ, me kërkesën e Kryesuesit të Komisionit në mbledhje morri pjesë Daut Beqiri – Drejtor i Departamentit Ligjor.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi, Nimon Alimusaj - nënkryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i listës së propozuar nga MKRS për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore.
3. Të ndryshme.

Pika parë e rendit të ditës -

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

Pika dytë e rendit të ditës -

Nimon Alimusaj – në fillim të mbledhjes prezantoi listën e MKRS-së, për emërimin e 7 anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore dhe i njoftoi anëtarët e Komisionit se këtë listë, Ministria e ka hartuar në bazë të një bashkëpunimi me Komisionin dhe marrëveshjes së hartuar nga Komisioni. Lidhur me këtë kryesuesi hapi debatin.

Genc Gorani – vërejtja e tij ishte në numrin e anëtarëve të propozuar nga MKRS dhe propozoi që ky numër të rritet në 14, në mënyrë që pastaj Komisioni ti selektojë 7 prej tyre, gjithashtu bëri disa vërejtje në procedura pasi që në dokument mungonin të dhënat personale për dy kandidatë.

Remzije Nimani – Ministria është dashur të kërkoj një listë më të gjerë nga Institucionet përkatëse dhe në Komision ta sjellë një listë të selektuar në mënyrë që Komisioni ta miratojë, sepse Komisioni nuk përzgjedh.

Mark Krasniqi – kërkoj që të mos kandidohet në këtë listë si anëtar i Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, pasi ishte kandidat i propozuar.

Përfaqësuesi i MKRS – i njoftoi anëtarët e Komisionit, se Komisioni duhet që sot të vendos dhe të miratoj listën e propozuar për emërimin e këtyre anëtarëve, për faktin se nuk ka kohë për vonesa, ngase Ministria nesër në një takim që ka për standarde – për standardin 6 dhe 7 për Trashëgiminë Kulturore, duhet të raportojë se kjo listë është e miratuar nga Komisioni (qoftë edhe me vërejtje). Lidhur me këtë çështje ai tha se, pasi z. Mark Krasniqi tërhiqet nga kandidatura, në vend të tij Ministria propozon të kandidohet z. Nimon Alimusaj dhe kjo listë të miratohet me këtë ndryshim.

Myrvete Dreshaj – pyeti, se cila është fuqia e Komisionit dhe në bazë të çfarë bashkëpunimi me Komisionin, Ministria ka propozuar këtë listë ?

Ajo tha se, sa herë që kemi në shqyrtim lista të tilla, për emërimet të bordeve dhe këshillave ka paqartësi dhe në kontekst të kësaj, pyeti se cili është roli konkret i Komisionit, a është Komisioni miratues formal i kësaj liste apo kemi një rol të caktuar dhe nëse është kështu, Komisioni mund ta ndryshojë këtë listë, duke potencuar se edhe herave të kaluara ky Komision për raste të tilla është gjetur para akteve të kryera dhe potencoi kur vendoset politikisht vendos politika, por kur vendosim për këshilla, për shkencë, ne duhet ti zgjedhim njerëzit adekuat.

Gjylshen Berisha – mbështeti listën e propozuar nga MKRS-ja, me ndryshimin e lartpërmendur.

Ragip Zekolli – kërkoj sqarime se në mbështetje të cilit dokument, Komisioni mund të propozon kandidatë të tjerë.

Genc Gorani – ai tha se nuk e kundërshton këtë listë dhe se nuk ka ndonjë kandidat për të propozuar, por kërkoj që të jenë referencat e të gjithë kandidatëve të propozuar, duke theksuar se si mund p.sh. Akademia e Shkencave të mos i propozoi dy kandidatë, si ekspertë më të mirë.

Nuk e shoh të arsyeshme se kjo listë nuk mund të ndryshohet, pasi që sipas Ligjit – neni 4.8, Kuvendi ka përgjegjësi për këtë Këshill dhe duke iu drejtuar përfaqësuesit të Ministrisë, pyeti, nëse Komisioni është para një akti të kryer, pse Ministria e bjen Komisionin në këtë situatë.

Duke kërkuar interpretime objektive dhe profesionale lidhur me emërimin e z. Alimusaj, se mos kjo sjell konflikt interesi dhe se këta kandidat të propozuar a marrin pjesë në borde tjera.

Kryesuesi i Komisionit për këto sqarime ia dha fjalën Drejtorit të Departamentit Ligjor –

Daut Beqiri, propozoi dhe interpretoi, pasi që Ligji nuk përcakton se a ka konflikt interesi, deputetët janë ata që vlerësojnë dhe marrëveshjet politike le të jenë pjesë e vendimeve të Komisionit.

Pas debateve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni propozoi që të votohet për listën e propozuar nga MKRS me një ndryshim që në vend të z. Mark Krasniqi të propozohet z. Nimon Alimusaj, votimi ishte 7 vota Për dhe 1 Abstenim – Genc Gorani.

Lidhur me këtë, Komisioni nxori:

R E K O M A N D I M

I Rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë listën e propozuar nga Ministria për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje Jorezidente për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë.

Arsyetim

Në bazë të një marrëveshje që Komisioni e ka arritur me Ministrinë për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje Jorezidente, Ministria në fjalë ka kërkuar nga Institucionet e ndryshme që ti rekomandojnë kandidatët për nominim, në mënyrë që kjo listë pastaj ti adresohet Komisionit përkatës për procedim të mëtejshëm.

Në mbledhjen e mbajtur me 18.07.07, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte, shqyrtoi dhe miratoi listën e propozuar të datës 09.07.07 nga Ministria për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje Jorezidente për emërimin e 7 anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, me ndryshimin e propozuar për anëtarin e parë, përkatësisht në vend të z. Mark Krasniqi, propozohet z. Nimon Alimusaj.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11:45

Nënkryetari i Komisionit:

Nimon Alimusaj